



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 333, datë 17.09.2020

PËR
ZGJATJEN E AFATIT TË KOMANDIMIT TË PËRKOHSHËM
SI INSPEKTOR NË ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË,
TË MAGJISTRATES ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147/a, pika 1, shkronja “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 168, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 86, shkronja “d”, nenin 97, pika 3 dhe nenin 283, pika 10, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qe qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 105, shkronja “c”, të Kodit të Procedurave Administrative, me kërkesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me shkresën nr.5/5 prot., datë 09.09.2020, si dhe pëlqimin e magjistrates së komanduar përkohësisht, dhënë me Shkresën nr.5/6 prot., datë 09.09.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të komandimit të përkohshëm si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të magjistrates znj. {...}, deri në përfundim të procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë ku ajo ka kandiduar.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 13.08.2020.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet magjistrates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR